

Fëmijët, të rinjtë dhe gjithëpërfshirja



uster

Wohnstadt am Wasser

FËMIJËT, TË RINJTË DHE FAMILJET INFORMACIONE DHE PROGRAME NË USTER



Numri i telefonit të mjekut

Numri i telefonit të mjekut për emergjencat e fëmijëve, të rinjve dhe të rriturve:

0800 33 66 55

Linja telefonike e këshillimit është e disponueshme 365 ditë në vit, 24 orë në ditë.

Në raste rreziku për jetën:

Linja e urgjencave shëndetësore **144**



Spitalet

Spital Uster • Brunnenstrasse 42, 8610 Uster • 044 911 11 11

Kinderspital Zürich • Steinwiesstrasse 75, 8032 Zürich • 044 266 71 11

Mjekët peditër

Kinderpraxis Uster

Winterthurerstrasse 18a, 8610 Uster • 043 444 23 33

Dr. mjek. Daniel Grün, Dr. med. Stephanie Stücheli-Herlach,

Dr. mjek. Katharina Müller-Weber

Quellenpraxis AG

Loren-Allee 22, 8610 Uster • 044 940 25 00

quellenpraxis@hin.ch

Dr. mjek. Irmela Heinrichs

Flor Gesundheitszentrum für Kinder und Eltern

Loren-Allee 20, 8610 Uster • 044 940 55 51

info@flor-gesundheitszentrum.ch

Dr. mjek. Regula Neidhardt, Dr. med. Alexia Moser

Dr. mjek. Susanne Dürst

Kinderarztpraxis

Florastrasse 10, 8610 Uster • 044 940 89 11

joerg.ersch@bluewin.ch

PD Dr. mjek. Jörg Ersch

E DASHUR FAMILJE

Me kënaqësi ju dorëzojmë broshurën e programeve për fëmijët, të rinjtë dhe familjet.

Këtu do të gjeni informacione për programet e ofruara në Uster, si kujdestari për fëmijët, këshillim dhe mbështetje.

Kjo broshurë përmban edhe informacione për aktivitete të ndryshme gjatë kohës së lirë dhe për jetën komunitare në Uster.

Qendra për fëmijët, të rinjtë dhe gjithëpërfshirjen është në dispozicionin tuaj si pikë e përgjithshme kontakti për pyetje dhe paqartësi.

PASQYRA E LËNDËS

Programe për familjet

Zyrat qendrore dhe këshillimi për familjet	6
Qendra për familjet në Uster	8
Programe të tjera	9

Programe për fëmijët dhe të rinjtë

Zyrat qendrore dhe këshillimi për fëmijët dhe të rinjtë	10
Puna me fëmijët dhe të rinjtë – e hapur për të gjithë	12
Lojërat shëtitëse në Uster	13
Sheshi i aventurave Holzwurm në Uster	14

Kujdestaria

Zyrat qendrore dhe këshillimi për kujdestarinë	15
Kujdestaria e fëmijëve në raste urgjente në Qendrën për familjet në Uster	16
Kujdestaria përtej familjes - FEB	17
Kopshtet / çerdhet	18
Tagesfamilien Zürcher Oberland	19
Grupet e lojërave	20

Programe për kohën e lirë

Klubet	23
Programe të tjera për kohën e lirë	26



ZYRAT QENDRORE DHE KËSHILLIMI PËR FAMILJET

Qendra për fëmijët, të rinjtë dhe gjithëpërfshirjen

Qendra për fëmijët, të rinjtë dhe gjithëpërfshirjen mbështet banoret dhe banorët e qytetit Uster. Ajo u ofron fëmijëve, të rinjve dhe familjeve programe të ndryshme dhe funksionon si pikë e përgjithshme kontakti për pyetjet e mundshme.

044 944 72 06 • kindheit@uster.ch

FABEL – Këshillim për familjet dhe prindërit

Zyra qendrore FABEL është në dispozicion të familjeve dhe të prindërve lidhur me pyetje dhe çështje të përditshmërisë familjare dhe të tranzicionit (p.sh. hyrja në shkollë). Shqetësimet dhe nevojat e prindërve janë fokusi kryesor.

Qendra për fëmijët, të rinjtë dhe gjithëpërfshirjen

Seraina Hostettler

079 876 72 92 • kindheit@uster.ch

www.familienzentrum-uster.ch/fabel

Shkolla fillore Uster

Në qendër të shkollës fillore qëndron kënaqësia e të mësuarit dhe e mësimdhënies. Në nëntë godina shkollash marrin mësim rreth 800 fëmijë kopshti dhe 2200 nxënës dhe nxënës. Programi arsimor dhe i kujdestarisë mbulon nevojat e fëmijëve të qytetit dhe të rajonit.

044 944 73 30 • ps@uster.ch

Qendra e ndihmës për fëmijët dhe të rinjtë në Uster (kjz)

Këshillim për edukimin

Këshillueset dhe këshilluesit e kjz Uster për edukimin ju ndihmojnë të kuptoni më mirë sjelljen e fëmijës suaj apo të të rinjve dhe të zgjidhni konfliktet. Shpesh vetëm disa biseda mund t'ju ndihmojnë të krijoni më shumë siguri në edukimin e fëmijës.

043 258 48 00

Këshillim për nënat dhe baballarët

Këshillueset për nënat dhe baballarët do të bisedojnë me ju për të gjitha çështjet që dëshironi dhe që kanë të bëjnë me zhvillimin, kujdesin, ushqyerjen dhe edukimin e fëmijës suaj të mitur. Në qendrën këshillimore ju mund ta masni e ta peshoni fëmijën tuaj, mund të informoheni rreth programeve të ndryshme për familjet në zonën tuaj, si dhe të takoheni me nëna dhe baballarët tjerë. Shërbimet janë pa pagesë dhe konfidenciale.

Schulweg 4, 8610 Uster

043 259 76 70 • www.zh.ch/kjz-uster

Pro Juventute – Këshillimi për prindërit

Kujdestaria dhe edukimi i fëmijëve dhe i të rinjve nuk është gjithmonë i lehtë. Sepse çdo fëmijë ndryshon nga tjetri. Dhe çdo familje ndryshon nga tjetra. Këshillimi për prindërit Pro Juventute u përgjigjet individualisht dhe profesionalisht pyetjeve të prindërve dhe të kujdestarëve, si dhe ofron mbështetje në situata emergjente. Linja telefonike e këshillimit është e disponueshme 365 ditë në vit, 24 orë në ditë.

058 261 61 61 • www.elternberatung.projuventute.ch



QENDRA PËR FAMILJET

Qendra për familjet funksionon si një klub i pavarur dhe menaxhohet nga qyteti Uster dhe me mbështetjen financiare të Zyrës për të rinjtë dhe këshillim profesional. Secili nga programet ofrohet nga një sërë organizatash të ndryshme dhe shpesh mundësohen nga përpjekje të mëdha dhe punë vullnetare.

Nënat, baballarët dhe fëmijët takohen me njëri-tjetrin në Qendrën për familjet në Uster. Ata ndjekin së bashku programet dhe ngjarje të ndryshme. Qendra për familjet është një pikë takimi e preferuar për prindërit. Ajo ofron gjithashtu edhe këshillime dhe kurse. Ka edhe specialistë të tjerë të jashtëm që ofrojnë programe pranë Qendrës për familjet. Për shembull, edhe rezidentët e rinj mund të mësojnë gjermanisht (ABC Deutschkurse).

Kafene të hapura për të gjithë me mundësi lojërash për fëmijë:

Nga e hëna në të premte (gjithë ditën)

Zentralstrasse 32, 8610 Uster

044 994 57 47 • info@familienzentrum-uster.ch

www.familienzentrum-uster.ch

WEITERE ANGEBOTE

Kinder-4

Këtu do të gjeni filma të shkurtër dhe informacione rreth të mësuarit në fëmijërinë e hershme në jetën e përditshme: **www.kinder-4.ch**.

Motoja është: "Nxsisim aftësitë gjuhësore të të gjithë fëmijëve dhe të rinjve. Në këtë mënyrë kanë të gjithë shanse të barabarta, në shkollë, në punë dhe në shoqëri."

Aplikacioni Parentu

Aplikacioni për informimin e prindërve, zhvillimin dhe edukimin e fëmijëve të moshës 0 deri 16 vjeç (në 13 gjuhë). Ky aplikacion mund të shkarkohet pa pagesë në App Store ose Google Play.

Boutique Jailhouse

Boutique Jailhouse është adresa kryesore në Uster për rroba dhe lodra të leverdisshme për fëmijë. Krahas një game të gjerë produktesh të dorës së dytë, do të gjeni edhe produkte origjinale nga Helly Hansen dhe rukka.

Freiestrasse 47, 8610 Uster

043 540 74 75 • info@jailhouse-uster.ch • www.jailhouse-uster.ch



ZYRAT QENDRORE DHE KËSHILLIMI PËR FËMIJËT DHE TË RINJTË

Qendra për fëmijët, të rinjtë dhe gjithëpërfshirjen

Qendra për fëmijët, të rinjtë dhe gjithëpërfshirjen mbështet banorët e qytetit Uster. Ajo u ofron fëmijëve, të rinjve dhe familjeve programe të ndryshme dhe funksionon si pikë e përgjithshme kontakti për pyetjet e mundshme.

044 944 72 06 • jugend@uster.ch

Parandalimi i varësive

Qendra për parandalimin e varësive trajton çështje të promovimit të shëndetit, të parandalimit të varësive dhe të varësive ekzistuese.

www.sucht-praevention.ch

Pro Juventute – Këshillim + ndihmë 147

Numri i linjës së emergjencave të Pro Juventute ndihmon fëmijët dhe të rinjtë për pyetje, probleme dhe në situata emergjence. Specialistët u përgjigjen të gjitha pyetjeve rreth familjes, dhunës, varësive, shkollës, punës, dashurisë, miqësisë dhe seksualitetit. Përveçse në **numrin e telefonit 147**, shërbimin Këshillim + ndihmë 147 e arrini edhe me SMS, me chat dhe me email.

Në këtë mënyrë, edhe fëmijët dhe të rinjtë që preferojnë të na kontaktojnë me shkrim më shumë sesa me telefon, kanë qasje në këtë shërbim pa pagesë të Pro Juventute. Në platformën e internetit **www.147.ch** fëmijët dhe të rinjtë do të gjejnë përgjigje të mëtejshme për pyetjet e tyre, si dhe shumë lidhje faqesh interneti dhe adresa të qendrave. Linja telefonike e këshillimit është e disponueshme 365 ditë në vit, 24 orë në ditë.

147 • beratung@147.ch • www.147.ch

Këshillimi profesional BIZ

Këshillim profesional, përgatitje profesionale ose praktika pune për nxënëset dhe nxënësit e shkollës së mesme

BIZ u vjen në ndihmë të rinjve dhe prindërve të tyre gjatë zgjedhjes së profesionit. Gjatë kërkimit të një vendi trajnimi ose të një zgjidhjeje të ndërmjetme, qartësohen së bashku interesat, aftësitë, dëshirat dhe idetë. Kërkesat e veçanta për programet e trajnimit balancohen me kualifikimet dhe dëshirat e fëmijës suaj. Në rast se nevojitet, do të kryhen edhe testime.

Këshillim SOS për të rinjtë - mbështetje në raste urgjente

Këshillueset dhe këshilluesit profesionalë kujdesen për të rinjtë që nuk kanë ende asnjë vend praktike mësimore. Programi quhet: "Çfarë të bëni nëse nuk keni një vend praktike mësimore?". Ka edhe programe të tjera në dispozicion. Këshillimet: Nga e hëna në të premte sipas takimit të rezervuar

Brunnenstrasse 1, 8610 Uster
043 258 49 00 • www.zh.ch/biz-uster

PUNA ME FËMIJËT DHE TË RINJTË NË USTER – E HAPUR PËR TË GJITHË

Puna me të rinjtë është e disponueshme për kërkesat e të rinjve në Uster. Ajo menaxhon “Dyqanin e të rinjve”, ku të rinjtë marrin mbështetje, këshillim dhe informacione për zbatimin e projekteve personale, për ngjarje dhe çështje të ndryshme të jetës.

Gjatë orareve të hapjes, këshillueset dhe këshilluesit e të rinjve janë të gatshëm të këshillojnë dhe të mbështesin të rinjtë. Ata mbledhin idetë, dëshirat dhe planet e tyre. Puna e të rinjve është e hapur edhe për prindërit, shkollat dhe institucionet e specializuara.

Freiestrasse 19, 8610 Uster
044 941 14 50 • jugend@uster.ch

frjz - Qendra për kohën e lirë dhe të rinjtë në Uster

Klubi “Koha e lirë dhe puna e të rinjve në rajonin Uster”, VFJRU, u themelua në vitin 1965 dhe është i pavarur nga politika dhe besimi. Klubi është aktiv në fushën e punës së të rinjve dhe komunitare (puna në kohën e lirë). Ai menaxhon qendrën për kohën e lirë dhe të rinjtë “frjz” në Uster.

Zürichstrasse 30, 8610 Uster
044 941 14 49 • info@frjz-uster.ch • www.frjz.ch



LOJËRAT SHËTITËSE NË USTER

Lojërat shëtitëse janë një autobus shumëngjyrësh i mbushur me lojëra, mjete lëvizëse argëtuese dhe materiale për punëdore. Ai vjen pranë fëmijëve të lagjes, në parkun e qytetit dhe në qarqet e jashtme. Lojërat shëtitëse u ofrojnë fëmijëve dhe të rriturve mundësinë që të punojnë në mënyrë krijuese. Të mësuarit mund të zhvillohet në mënyrë argëtuese dhe pa presion.


Lojërat shëtitëse janë një vendtakim çlodhës për shumë njerëz: Të rinj e të moshuar, të pasur e të varfër, zviceriane e zviceranë dhe njerëz nga vende të ndryshme. Ato luajnë një rol të rëndësishëm për integrimin. Lojërat shëtitëse u sjellin kënaqësi fëmijëve dhe e pasurojnë qytetin dhe jetën e tij kulturore.

Kur vijnë lojërat shëtitëse?

Nga muaji prill deri në tetor, autobusi i lojërave shëtitëse qarkullon gjatë periudhës së shkollës çdo pasdite të së mërkurës dhe të së shtunës, nga ora 13:00 deri në orën 17:00 në lagje të ndryshme në Uster, në parkun e qytetit dhe në fshatrat përreth. Në dimër, ky program organizohet nëpër palestra. Në pranverë, verë dhe vjeshtë organizohen javë tematikash interesante. Nga e hëna në të premte, nga ora 10:00 deri në orën 12:00 dhe nga ora 13:30 deri në orën 17:00 organizohet një program pushimesh, ku mund të marrin pjesë të gjithë. Autobusi i lojërave shëtitëse qëndron në parkun e qytetit Uster ose bën ekskursione aventureske. Datat dhe vendet aktuale i gjeni në kalendarin e orareve: **www.spielmobil-uster.ch/fahrplan**

Veprimtaritë janë të hapura për të gjithë, janë pa pagesë dhe organizohen në të gjitha kushtet e motit – përveçse në shi të vazhdueshëm dhe stuhi. Nuk nevojitet regjistrim.

**Fondacioni Arbeitsgestaltung,
Berchtoldstrasse 3, 8610 Uster
076 418 81 99 • spielmobil@arbeitsgestaltung.ch
www.spielmobil-uster.ch**



SHESHI I AVENTURAVE HOLZWURM NË USTER

Sheshi i aventurave Holzwurm iu ofron fëmijëve një hapësirë të lirë. Në botën e sotme tejet të strukturuar, këto hapësira të lira janë të rëndësishme. Sheshi i lojërave synon të jetë si më poshtë: Ishull aventurash, hapësirë e ndërtuar me fantazi dhe vend krijues. Ai duhet të mundësojë spontanitet, novacion, argëtim dhe lojëra në natyrë. Holzwurm ofron hapësirë për aktivitete në grup, lojëra dhe çlodhje. Pa presionin e arritjeve dhe pa udhëzime të përcaktuara, këtu fëmijët mund t'i provojnë gjërat lirisht. Ajo që promovohet është puna e pavarur, ndjesia e të qenët pjesë e një grupi si dhe ofrohen mundësi për të njohur kufijtë. Ofrohet gjithashtu hapësira e nevojshme për krijimtari. Ekipi kujdestar është aty për të ndihmuar në rast konfliktesh dhe i ndihmon fëmijët për të vënë në jetë idetë e tyre.

Fëmijët dhe të rinjtë duhet të jenë në gjendje ta organizojnë kohën e tyre të lirë mundësisht me vetë iniciativën e tyre. Për këtë arsye, Holzwurm synon të jetë një vend ku fëmijët të vijnë e të ikin sipas dëshirës, si dhe një vend ku të mund të lënë gjurmët e tyre, pa asnjë pritshmëri dhe presion arritjesh. Të rriturit në Holzwurm u vënë atyre të dispozicion vendin, hapësirën, materialin, mjetet dhe, sipas nevojës, edhe mbështetjen e tyre. Është e rëndësishme që ata të mund t'i realizojnë vetë idetë e tyre, pa u ndier të detyruar të përmbushin "kërkesat e të rriturve".

Hapësira e gjerë ofron shumë mundësi për të luajtur, për t'u ngjitur në lartësi, për të ndërtuar kasolle, për të ndezur zjarr, për të luajtur në rërë e shumë të tjera si këto. Sheshi i aventurave është i hapur përkatësisht si më poshtë:

Të martën pasdite për fëmijët e kopshtit
(të shoqëruar)

Të mërkurën pasdite për fëmijët e shkollës
(ku përfshihen programe saldimi, punëdoreje dhe punimesh të tjera)

Të enjten dhe të premten pasdite për të gjithë
(fëmijët e vegjël të shoqëruar)

Hinterwiesenweg 3, 8610 Uster
077 449 72 44 • info@holzwurm-uster.ch
www.holzwurm-uster.ch

abenteuer
spielplatz
**HOLZ
WURM**



ZYRAT QENDRORE DHE KËSHILLIMI PËR KUJDESTARINË

Në Uster ka shumë grupe lojërash (me ose pa mbështetje gjuhësore të veçantë), kopshte dhe çerdhe. Më poshtë do të gjeni një gamë të gjerë mundësish, rreth mënyrave se si ofrohet kujdesi ndaj fëmijëve tuaj. Nëse keni pyetje, Qendra për familjet ose Qendra për fëmijët, të rinjtë dhe gjithëpërfshirjen janë në dispozicionin tuaj.

Qendra për familjet në Uster

044 994 57 47 • info@familienzentrum-uster.ch

Qendra për fëmijët, të rinjtë dhe gjithëpërfshirjen

044 944 72 06 • kindheit@uster.ch

KUJDESTARIA E FËMIJË-VE NË RASTE URGJENTE NË QENDRËN PËR FAMILJET NË USTER

Ka raste kur ju duhet urgjentisht një dado. Për shembull, kur një babai të papunë i duhet të shkojë papritur në një provë pune, ose kur një nënë beqare nuk dëshiron ta lërë vetëm në shtëpi fëmijën e sëmurë.

Në këto raste, kujdestaria e fëmijëve në raste urgjente që ofron Qendra për familjet në Uster është zgjidhja e duhur. Ndihma e ofruar përfshin kujdestarinë e fëmijës në raste urgjente, shpejt dhe pa komplikime nga një person i kualifikuar.

- Shërbimi i kujdestarisë ofrohet për fëmijë nga **0 deri 12 vjeç**.
- Shërbimi i kujdestarisë realizohet **në shtëpinë tuaj**.
- Qëllimi është të sigurojmë shërbim kujdestarie **brenda 2 orësh**, por kjo varet edhe nga disponueshmëria e dadove.
- Shërbimi i kujdestarisë ofrohet **nga e hëna në të premte** nga ora 7:00 deri në orën 19:00.
- Kohëzgjatja e shërbimit të kujdestarisë është **nga 2 deri në 8 orë**.

Zentralstrasse 32, 8610 Uster

076 498 99 82 • info@familienzentrum-uster.ch

www.kinder-notfall-betreuung.ch

KUJDESTARIA PËRTEJ FAMILJES - FEB

FEB është grupi i shërbimeve për kujdestarinë përtej familjes. Ai lidh kontrata me çerdhe dhe qendra private të kujdesit ditor. Këto quhen kontrata shërbimesh. Në to përcaktohet se çfarë duhet të ofrojnë çerdhet dhe qendrat e kujdesit ditor dhe çmimin e tyre. Ofruesit e ndryshëm të kujdestarisë së fëmijëve bëjnë pjesë në të ashtuquajturin Grupi FEB.

Qyteti Uster u paguan prindërve kontribute për kujdestarinë e fëmijëve të tyre nga një prej institucioneve të grupit FEB. Kontributet bazohen në të ardhurat e taksueshme dhe në zotërimet e prindërve. Nëse prindërit banojnë jashtë qytetit Uster, ata nuk i marrin kontributet nga ky qytet. Prindërit duhet të bëjnë kërkesë për kontribut për çerdhet e fëmijëve.

Qyteti Uster nuk ndërmjetëson vende në qendrat e kujdestarisë së fëmijëve. Për të gjetur një vend të lirë, kontaktoni drejtpërsëdrejti me ofruesit e shërbimeve të kujdestarisë.

Në Grupin FEB bëjnë pjesë:

- Kinderkrippe Beluga
- Kinderkrippe Heusser Staub
- Hort im Lot
- Kinderkrippe Muulwurf
- Kinderkrippe und Hort Ramba Zamba
- Kinderkrippe Schatzkiste
- KiTa Seegarten
- Tagesfamilienverein Zürcher Oberland

Stadt Uster, Bahnhofstrasse 17, 8610 Uster
044 944 71 82 • feb@uster.ch • www.uster.ch/feb

KOPSHTET / ÇERDHET

Chinderhuus im Werk • Im Werk 3, 8610 Uster
info@chinderhuusimwerk.ch • www.chinderhuusimwerk.ch

Verein Kinderhaus Mary Poppins • Zentralstrasse 36, 8610 Uster
info@kinderkrippe-uster.ch • www.kinderkrippe-uster.ch

Hort im Lot • Im Lot 11, 8610 Uster
mail@hortimlot.ch • www.hortimlot.ch

KiTa Chinderkram • Apothekerstrasse 18, 8610 Uster
info@kita-chinderkram.ch • www.kita-chinderkram.ch

KiTa Seegarten • Seefeldstrasse 4a, 8610 Uster
info@kitaseegarten.ch • info@kitaseegarten.ch

KiTa Zipfelchappe • Uster West 30, 8610 Uster
mail@kita-zipfelchappe.ch • www.kita-zipfelchappe.ch

KiTa Muulwurf • Industriestrasse 23, 8610 Uster
info@muulwurf.ch • www.muulwurf.ch

Kinderkrippe Schatzkiste • Lorenweg 1, 8610 Uster
info@krippeschatzkiste.ch • www.krippeschatzkiste.ch

Kinderkrippe Ramba-Zamba • Weiherallee 3, 8610 Uster
info@ramba-zamba.ch • www.ramba-zamba.ch

Kinderkrippe Heusser-Staub • Florastrasse 26, 8610 Uster
info@kinderkrippeheusserstaub.ch • www.kinderkrippeheusserstaub.ch

Integrative Kinderkrippe Beluga • Asylstrasse 24, 8610 Uster
beluga@wagerenhof.ch • www.wagerenhof.ch

«Fugu» Kinderkrippe Uster • Braschlergasse 8, 8610 Uster
uster@kitafugu.ch • www.kitafugu.ch/uster

TAGESFAMILIEN ZÜRCHER OBERLAND

Klubi Tagesfamilien Zürcher Oberland TFZO ndërmjetëson kujdestari fëmijësh, individuale dhe me atmosferë familjare, nëpër familje të kualifikuara të kujdesit ditor. Oraret e kujdestarisë caktohen sipas nevojave individuale. Zyra e TFZO ofron këshillim të specializuar, ndërmjetësim dhe mbështetje për prindërit dhe kujdestarët e fëmijëve.

Oraret e zyrës:

E hënë – e premte, orari 09:00 – 12:00 dhe 13:30 – 16:00

Spitalstrasse 29, 8630 Rüti ZH

076 348 86 20 • info@tfzo.ch • www.tfzo.ch



GRUPET E LOJËRAVE

Grupet e lojërave me mbështetje të veçantë gjuhësore

BiLiKiD

Grupi i lojërave BiLiKiD u ofron fëmijëve nga tre deri në pesë vjeç një mjedis të përshtatshëm për ta. Këtu ata kanë mundësinë të luajnë në gjuhën e tyre amtare dhe njëkohësisht të mësojnë gjermanishten e Zvicrës. Kjo do të thotë se fëmijët zhvillohen në gjuhën e tyre amtare. Kjo nxit zhvillimin e tyre gjuhësor dhe mendor. Ata mësojnë njëkohësisht terma dhe fjalë kyçe në gjermanishten e Zvicrës. Ky është një avantazh, nëse më vonë do të shkojnë në kopsht. Qëllimi është t'u lehtësohet fëmijëve hyrja në shkollë dhe rruga e mëtejshme e studimeve. Kjo u jep atyre mundësi më të mira për të filluar. Në Uster grupi BiLiKiD e ofron programin e tij në gjermanishten e Zvicrës dhe në turqisht.

Familienzentrum Uster, Zentralstrasse 32, 8610 Uster
052 534 58 91 • info@bilikid.ch • www.bilikid.ch

Glüehwürmli

Glüehwürmli është një grup lojërash me mbështetje gjuhësore. Këtu fëmijët e vegjël mësojnë gjermanishten e Zvicrës përmes lojërave. Dy drejtueset janë persona të kualifikuar. Në këtë grup, fëmijët rreth moshës tre vjeç mund të bëjnë përvojat e tyre të para jashtë familjes, derisa të arrijnë moshën e kopshtit. Fëmijët e së njëjtës moshë do të gjejnë këtu kontakte dhe do të përfitojnë nga një përzgjedhje programesh të ndryshme. Në Glüehwürmli fëmijët mund të luajnë lirisht, mund të bëjnë punime, të këndojnë, të dëgjojnë histori, të krijojnë dhe të eksperimentojnë. Fëmijët mësojnë dhe ushtrojnë gjermanishten. Njohuritë e tyre gjuhësore ushtrohen, zgjerohen dhe nxiten më tej.

Im Werk 8, 8610 Uster
044 212 14 41 • petra_imseng@hotmail.com • www.gluehwuermli.ch

kidin.ch

Formimi i hershëm optimal i fëmijës suaj, kujdestaria dhe mbështetja është fokusi kryesor i këtij grupi lojërash. Ai mbështet procesin e zhvillimit të çdo fëmije dhe ofron gjithashtu një mjedis të larmishëm dhe stimulues. Këtu fëmija juaj mund të mësojë në mënyrë individuale.

Këtu aplikohen parimet filozofike të Maria Montessori dhe Rudolf Steiner. Të qenët në lëvizje, loja e lirë, puna krijuese dhe ushqyerja e shëndetshme janë elemente të rëndësishme. Po ashtu, gjatë mesvaktit të paradites në grupin e lojërave ka çdo ditë tregim historish, vjersha dhe këngë. Fëmija juaj duhet të ndihet si në shtëpi. Për këtë arsye i mbajmë grupet të vogla, duke krijuar kështu një atmosferë familjare.

Që prej vitit 2011, grupi i lojërave ndjek konceptin "Formim i hershëm gjuhësor". Objektivi është nxitja e zhvillimit gjuhësor sa më herët të jetë e mundur.

Turicaphonstrasse 31, 8616 Riedikon
076 366 88 11 • info@kidin.ch • www.kidin.ch

WACkelöhrli

WACkelöhrli është grup lojërash Plus, i cili vë një theks të rëndësishëm në zhvillimin gjuhësor (në gjermanishten e Zvicrës dhe në anglisht) dhe zhvillon lojëra interesante për këtë qëllim. Grupi i lojërave fton gjithë fëmijët e moshës 2 deri në 5 vjeç, të cilët kanë qejf të luajnë, të këndojnë, të bëjnë punëdore, të dëgjojnë histori dhe, jo më pak e rëndësishme, të mësojnë se çfarë do të thotë të shkosh mirë me fëmijët e tjerë bashkëmoshatarë. Ky grup lojërash ofrohet nga Women's Activity Club (WAC), një organizatë vullnetare në Uster.

Winterthurerstrasse 18, 8610 Uster
043 305 92 50 • ltcschool@wac.ch • www.wac.ch

Grupe të tjera lojërash

Spanische Spielgruppe Lindos Matices

Familienzentrum Uster, Zentralstrasse 32, 8610 Uster
Miriam Baumann ▪ 079 816 96 31 ▪ migucha2001@yahoo.com

Spielgruppe Summervogel ▪ Aathalstrasse 38A, 8610 Uster
vgalvao@bluewin.ch ▪ www.spielgruppesummervogel.ch

Spielgruppe Chindernäscht M.A.Schumacher

Schwerzistrasse 21, 8606 Nänikon ▪ Werrikon ▪ chindernaescht@gmx.ch

Spielgruppe Ameisinäscht ▪ Tännbergstrasse 1, 8610 Uster
info@ameisinaescht.ch ▪ www.ameisinaescht.ch

Spielgruppe Lukiluks

Gerichtsstrasse 8, 8610 Uster ▪ www.lukiluks.ch

Rudolf Steiner Spielgruppe Sonnenberg

Wildsbergstrasse 22, 8610 Uster
info@spielgruppe-sonnenberg.ch ▪ www.spielgruppe-sonnenberg.ch

Spielgruppe Spielchische Uster ▪ Asylstrasse 2, 8610 Uster
info@spielchische-uster.ch ▪ www.spielchische-uster.ch

Spielgruppe Trückli ▪ frjz Uster, Zürichstrasse 30, 8610 Uster
trueckliuster@gmx.ch ▪ www.trueckliuster.jimdofree.com

Waldspielgruppe Wurzeln ▪ Murggenstrasse 32, 8606 Nänikon
hanne.grimm@gmx.ch ▪ www.waldspielgruppe-wurzeln.ch

Waldkinder Uster

An verschiedenen Orten im Wald, 8610 Uster
info@waldkinderuster.ch ▪ www.waldkinderuster.ch

Claudia's Chinder-Stübli ▪ Haberweidstrasse 33, 8610 Uster
078 606 65 13 ▪ www.claudias-chinderstuebli.ch



KLUBET

Klubet janë një element thelbësor i jetës sportive, kulturore dhe shoqërore në qytetin Uster. Falënderojmë gjithë vullnetarët që janë të angazhuar në një klub dhe kontribuojnë ndjeshëm në cilësinë e jetës dhe në identitetin e qytetit Uster.

Në faqen e internetit të qytetit Uster do të gjeni një listë me klubet përkatëse në Uster.

www.uster.ch/vereinsliste

Më poshtë renditen disa klube që merren aktivisht me punën me fëmijët dhe të rinjtë në klub si dhe që nxisin talentet e reja.

Klubet sportive

Judo Club Uster

www.judo-club-uster.ch ▪ 079 829 8891 ▪ info@jcu.ch

Boxclub Uster

www.boxclubuster.ch ▪ 079 103 14 16 ▪ kontakt@boxclubuster.ch

Chin Woo Kung Fu

www.chinwoo-uster.ch ▪ 044 905 87 77

FC Uster

www.fcuster.ch ▪ 079 583 67 78 ▪ sekretariat@fcuster.ch

FC Rot Weiss Winikon

www.fc-rw.ch ▪ 044 941 44 19 ▪ info@fc-rw.ch

Footrebel SOCCER Uster

www.footrebel.com ▪ play@footrebel.com

Unihockey Club Uster

www.uhcuster.ch ▪ info@uhcuster.ch

CESIU (Italienischer Ski- und Exkursionsclub Uster)

www.cesiu.ch ▪ 079 335 46 56 ▪ info@cesiu.ch

TV Uster Leichtathletik und Volleyball

www.tvuster.ch ▪ 079 358 08 35 ▪ praesident@tvuster.ch

TV Uster Handball

www.tvu.ch ▪ 079 770 01 36 ▪ walter.flessati@cosb.ch

Frauenturnverein

www.ftv-uster.ch ▪ praesidentin@ftv-uster.ch

Sportclub Satus Uster Kunstturnen

www.satus-uster.ch ▪ 044 932 63 06 ▪ praesident@satus-uster.ch

Sportclub Nänikon

www.scn.ch ▪ 044 941 06 67 ▪ praesident@scn.ch

Schwimmclub Uster

www.scu.ch ▪ 079 405 44 45 ▪ philippe.walter@scuw.ch

Squash-Club Uster

www.squash-arena.ch ▪ 044 515 95 77 ▪ info@squash-arena.ch

Tennisclub Uster

www.tcuster.ch ▪ 079 409 73 63 ▪ peter.leemann@tcuster.ch

Voltige-Club Harlekin

www.voltige-harlekin.ch ▪ info@voltige-harlekin.ch

Kunstradfahrer Uster

www.kunstradfahrer-uster.ch ▪ 079 314 91 83 ▪ katrin_gubler@hotmail.com

Klube të tjera

Musikschule Uster Greifensee

www.msug.ch ▪ 044 940 78 00 ▪ msug@musikschule-msug.ch

Pfadi Uster-Greifensee

www.pfadi-uster-greifensee.ch ▪ 076 423 71 85 ▪ al@pfadi-uster-greifensee.ch

CEVI Uster

www.cevi-uster.ch ▪ 044 942 00 77 ▪ stephan.goeldi@cevi.ch

JuBla Uster

www.jubla-uster.ch ▪ 076 442 59 55 ▪ mibad@bluewin.ch

Modellfluggruppe Uster

www.mg-uster.ch ▪ 079 632 04 41 ▪ martin@wunderli.ch

PROGRAME TË TJERA PËR KOHËN E LIRË

Biblioteka e qytetit dhe e rajonit Uster

Biblioteka e qytetit dhe e rajonit Uster ofron mbi 50 000 produkte: Libra, revista, gazeta, filma, lojëra e shumë të tjera. Përveç kësaj, atje do të gjeni një kafene, kënde kompjuterash dhe internet WLAN.

Bankstrasse 17, 8610 Uster
044 944 77 50 • info@stadtbibliothek-uster.ch
www.stadtbibliothek-uster.ch

Ludoteka

Ludoteka në Uster ofron lojëra dhe lodra për të gjitha moshat. Edhe të rriturit do të gjejnë këtu gjëra tërheqëse. Ka kategori të ndryshme lojërash: Lojëra tavoline, ndërtim e projektim, elektronikë, lojëra lëvizshmërie e të tjera.

Tannenzaunstrasse 8, 8610 Uster
044 940 05 81 • info@ludothek-uster.ch • www.ludothek-uster.ch

Dorfbad Uster

Dorfbad ndodhet në mes të qendrës. E megjithatë është qetë dhe ofron çlodhje. Për këtë arsye është ideal për t'iu larguar frenetizmit të jetës së përditshme. Ofrohet: Pishinë (25 m), pishinë për fëmijë të vegjël, kioskë me menu dreke dhe mesvakte, vend për skarë, shesh lojërash për fëmijë.

Florastrasse 22, 8610 Uster
044 943 59 20 • dorfbad@uster.ch • www.uster.ch/dorfbad

Pishinë e brendshme në Uster

Pishina më e madhe e brendshme në Zvicër ofron sa më poshtë: Pishinë olimpike (50 m), 2 pishina (25 m), rrëshqitëse (55 m), hapësirë për fëmijët e vegjël, hapësirë për spa, restorant bistro.

Hallenbadweg 3, 8610 Uster
044 943 59 10 • hallenbad@uster.ch • www.uster.ch/hallenbad

Strandbad Uster

Strandbad ka një pozicion idilik buzë liqenit. Në të do të gjeni shumë gjëra: Pishinë sportive (50 m), pishinë-kamerdare, shesh lojërash për fëmijë, fushë dyshe për volejboll plazhi, restorant.

Uferweg 7, 8610 Uster

044 943 59 25 • strandbad@uster.ch • www.uster.ch/strandbad

Griffig Sallë për ngjitje në lartësi dhe lojë me raketa

Salla ka një sipërfaqe për ngjitje mbi 3800 metra katrorë, 7 fusha për lojë me raketa, restorant bistro, dyqan për aksesore ngjitjesh, sallë seminaresh.

Hallenbadweg 2, 8610 Uster

044 515 95 77

Salla për ngjitje në lartësi: **www.griffig.com**

Salla për lojërat me raketa: **www.squash-arena.ch**

Pista të jashtme

Pistat e jashtme ofrojnë mundësi për shumë gjëra. Ato mundësojnë stërvitje sportive individuale. Helsana-Trails dhe Zurich Vitaparcours janë për të gjithë, si për vrapuesit e shpejtë ashtu edhe për vrapuesit e zakonshëm, si për të rinj ashtu edhe për të vjetër.

Pikënisja e

Helsana-Trail:

Chalchtarenweg, 8615 Uster

Mühliholzweg beim Findlingsgarten, 8610 Uster

Pikënisja e

Vitaparcours:

Hallenbadweg, 8610 Uster

www.uster.ch/anlagen

Qyteti Uster

Qendra për fëmijët, të rinjtë dhe gjithëpërfshirjen

Bahnhofstrasse 17

8610 Uster

044 944 72 06

079 876 72 92 (WhatsApp)

Email

Familja dhe mbështetja e hershme: **kindheit@uster.ch**

Fëmijët dhe të rinjtë: **jugend@uster.ch**

Klubet: **vereine@uster.ch**